



**BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE**

(Pasqyra 14/Sh)

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

MARS 2021

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin mars 2021 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në te gjithë bashkitë e vendit.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit mars 2021 zënë 23.68 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 81.71 /100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë (1.88/100.000 banorë). Rrethet Berat, Bulqizë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

NJVKSH Shkodër ka raportuar 3 raste me Salmonelozë jotifoide për muajin mars 2021, dhe paraqet një incidencë 2.21/100.000 banorë dhe NJVKSH Korçë ka raportuar 1 rast me Salmonelozë jotifoide (Incidenca 1.31 /100 000 banorë). Të gjitha rastet janë konfirmuar në laboratorin e rrethit përkatës.

Bashkia Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin mars 2021 në nivel kombëtar, përkatësisht me incidencë 5.9 /100.000 banorë (8 raste të konfirmuara).

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin mars 2021
(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste Mars 2021	Incidenca Mars 2021 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmonelozë	4	0.14
Shigelozë (Disenteri bacilare)	8	0.28
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	54	1.88
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	2273	79.4
Sëmundje diarreike në total	2339	81.71

2. Sëmundjet e EPI

2.1 Fruthi

Gjatë muajit mars 2021 nuk kemi raste të raportuara të dyshuara për fruth. Nëse e krahasojmë me një vit më parë, gjatë muajit mars 2020 janë testuar në total 2 raste të dyshuara me fruth nga Tepelena dhe Gjirokastra.

2.2 Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit mars 2021 janë raportuar 15 raste me Tuberkuloz pulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike 13 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Rastet janë të shpërndara në të gjithë vendin në: Durrës, Diber, Puke, Shkoder, dhe Tirane. Duke e krahasuar me një vit më parë në muajin mars 2020 janë raportuar 5 raste me Tuberkuloz pulmonar dhe rastet kanë qenë të shpërndara në të gjithë vendin në: Durrës, Bulqize dhe Kurbin.

Gjatë muajit mars 2021 janë raportuar 6 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike 6 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me

familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Rastet janë të shpërndara: 2 raste në Fier (incidenca 1.65/100.000 banorë) dhe 4 raste në Tiranë (incidenca 0.71/100.000 banorë).

3. Zoonozat

Gjatë muajit mars me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh është raportuar në nivel vendi një rast i dyshuar me bruceloze në Pogradec.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidentat e sëmundjeve Zoonotike në Mars 2021
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste, Mars 2021	Incidenca Mars 2021 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	1	0.03
Leptospirozë	0	0
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit mars 2021 janë raportuar në total 17 raste me hepatite virale B (Incidenca 0.59/100.000 banorë) nga të cilat, 16 janë hepatit viral B të konfirmuar në Tiranë (incidenca 2.87 /100.000 banorë) dhe 1 rast i dyshuar me hepatit viral B në Pogradec. Në lidhje me hepatitin viral A as B janë raportuar tre raste të konfirmuara në Tiranë (Incidenca 0.53/100.000 banorë).

5. HIV/AIDS

Në muajin mars 2021 janë kryer në total 28 ekzaminime për HIV në Njësinë e Laboratorëve në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), 15 meshkuj dhe 13 femra. Nga këto ekzaminime, 6 prej tyre kanë rezultuar pozitive (5 meshkuj dhe 1 femër). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme, përkatësisht nga 26 deri 58 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Krujë, Erseke dhe Berat. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur

në ISHP nga QSUT (Spitali Infektiv), QKTGJ, vullnetar, Laborator Privat (Intermedica dhe ALNET) dhe shoqata të ndryshme.

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK
DEKSI